



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1491 prot.

Ballsh, më 31/03 .2026

VENDIM

Nr. 19, datë 25.03 .2026

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR.50, DATË 23.12.2025 ‘PËR MIRATIMIN E
NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË MALLAKASTËR,
INSTITUCIONEVE NË VARËSI, FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA DHE
DELEGUARA PËR VITIN 2026, TË NDRYSHUAR”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo –territoriale të njësive të qeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar, të ligjit nr. 35/2023 “ Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Vendimit nr.87 datë 06.02.2026”Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, “ Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar, Vendimit nr.127 datë 27.02.2026 ”Për disa ndryshime në Vendimin Nr.425, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, VKM-së nr.776 datë 19.12.2025”Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”;

VENDOSI:

- I. Një ndryshim, në VKB-në nr.50 datë 23.12.2025''Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026'' të ndryshuar.
- II. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar sipas lidhjes nr.1 pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Efektet financiare do të fillojnë nga data 01.01.2026.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj



Lidhja nr.1

Vendos:
Kryetar
Nexhmi Sulaj



Niveli i pagave për Funksonet e transferuara nga arsimi (drejtores kopshti, edukatore kopshti, sekretare shkollë të mesme, QKF) dhe Shërbimi mbështetës (Sanitare, roje shkollë, punetore kuzhine etj).

Lidhja nr.1

Nr.	Klasa	Emërtimi	Arsimi	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa e pozicionit
1.		Drejtor i QKF-së	I lartë	1	10 vjeçari parë 0,6%/vit	10%e PG 20%e PG 30%e PG	102 000
2.		Përgjegjës Sektori ne QKF	I lartë	1	-//-	10%e PG 20%e PG 30%e PG	76.000
3.		Instruktor në QKF	I lartë	1	-//-	10%e PG 20%e PG 30%e PG	63.000
4.		Drejtor i Kopshtit me ushqim	I lartë	1	-//-	10%e PG 20%e PG 30%e PG	82.000
5.		Drejtor i Kopshtit pa ushqim	I lartë	1	-//-	10%e PG 20%e PG 30%e PG	77.000
6.		Edukatore në kopësht fëmijësh	I lartë	1 ose 2 ose 3 ose 4	-//-	10%e PG 20%e PG 30%e PG	61000
7.	VIII	Sekretare e shkollës së mesme	Vkm nr.326 datë 31.05.2023 e ndryshuar	I Mesem	1%		54100
8.	V	Kuzhinierë	Vkm nr.326 datë 31.05.2023 e ndryshuar	I Mesem	1%		52800
9	II	Ndihmës Kuzhinierë	Vkm nr.326 datë 31.05.2023 e ndryshuar	I Mesem	1%		51000
10.	I	Rrobalarëse, pjatolarëse, sanitare në kopësht dhe shkollë, roje të institucioneve arsimore	Vkm nr.326 datë 31.05.2023 e ndryshuar	I Mesem	1%		50000